



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK 1309/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI110/18

Parashtrues

Isuf Musliu

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave në
Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan,
përkitazi me lëndën C. nr. 296/16**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Isuf Musliu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt konkret të autoriteteve publike. Ai konteston kohëzgjatjen e procedurave përkitazi me gjykimin e lëndës C. nr. 296/16, që është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës C. nr. 296/16.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur në mënyrë specifike ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), për të cilën konsideron se është shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 gusht 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 15 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 27 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë formularin e kërkesës së Gjykatës.
9. Më 28 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në formë të kërkesës të cilën e adresoi për Kryetaren e Gjykatës.
10. Më 4 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës me të njëjtat dokumente të cilat ai tashmë i kishte dorëzuar më 3 gusht 2018.
11. Më 7 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës përsëri dorëzoi në Gjykatë një letër të adresuar për Kryetaren e Gjykatës.
12. Më 27 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 2 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore për anulimin e kontratës mbi dhuratën e lidhur ndërmjet F. M., në njërën anë dhe H. M., A. M. dhe A. M., në anën tjetër, lidhur me një numër të ngastrave kadastrale në fshatin Pjetershticë, komuna e Shtimes (në tekstin e mëtejme: ngastrat e kontestuar) dhe kërkoi që Gjykata Themelore t'ia vërtetojë parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë në ngastrat e kontestuar.
14. Më 9 shtator 2013, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin C. nr. 210/11, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës.
15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit C. nr. 210/11.
16. Më 15 korrik 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit CA. nr. 3781/2013, e prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 210/11, dhe ktheu rastin në rigjykim në Gjykatën Themelore, ku lënda është regjistruar me numrin e ri C. nr. 296/16. Gjykata e Apelit vërtetoi se Gjykata Themelore bëri shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 197 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase nuk e kishte hapur shqyrtimin e plotë për vërtetimin e faktit të kontestuar nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë kontribut për ngastrat e kontestuar të cilat kanë qenë objekt i kontratës së dhuratës.
17. Më 10 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore ku ankohet për mungesën e palëve në seancën e 4 gushtit 2017 dhe dështimin e Gjykatës Themelore për të siguruar dërgimin e ftesave tek palët. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i propozoi Gjykatës Themelore që ftesat për palët në procedurë të dërgohen në mënyrë personale, dhe jo përmes postës “që seanca e ardhshme të zhvillohet normalisht, pa vonesa të mëtejshme”.
18. Më 11 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore, duke kërkuar që palëve në procedurë t’iu caktohen përfaqësuesit e përkohshëm pasi ata nuk po paraqiten në seancë me qëllim të zvarritjes së procedurës si dhe që seanca e ardhshme të caktohet në afat sa më të shkurtër.
19. Më 23 tetor 2017, sipas kërkesës së parashtruesit, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në lidhje me lëndën e parashtruesit, e përjashtoi nga gjykimi gjyqtarin Z. T. dhe e zëvendësoi me gjyqtarin A. G.
20. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kallëzim penal kundër gjyqtarit Z. T. për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar, lidhur me rastin C. nr. 296/16.
21. Më 16 janar 2018, parashtruesi i kërkesës është intervistuar nga prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në lidhje me kallëzimin penal të paraqitur kundër gjyqtarit Z. T.

22. Më 13 shkurt 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, e cila është regjistruar me shenjën KI18/18.
23. Më 30 maj 2018, Gjykata shqyrtoi kërkesën e parashtruesit dhe nxori Aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës në rastin KI18/18.
24. Në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI18/18, Gjykata gjeti se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave pranë gjykatave të rregullta, prej 6 (gjashtë) vitesh dhe gjashtë muaj, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e rastit si dhe sjelljen e të gjitha palëve në procedurë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi në kërkesën e re KI110/18, nuk specifikoi asnjë të drejtë të paraparë me Kushtetutë për të cilën pretendon se është shkelur nga gjykatat e rregullta, por përsërit të njëjtat argumente të cilat tashmë ai kishte parashtruar në kërkesën KI18/18 dhe të cilat tashmë janë shqyrtuar nga Gjykata. Këto pretendime ishin:
 - a) Se përkundër faktit që Gjykata e Apelit me kthimin e rastit në rigjykim paraqiti sugjerime specifike për mënjanimin e shkeljeve që janë bërë nga Gjykata Themelore, ajo nuk vendos për rastin e tij edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme ligjore që lënda të vendoset.
 - b) Se ai dhe avokatët e tij janë duke u përballur me kërcënimin e Gjykatës Themelore se *“ka të drejtë që lëndën ta mbajë në sirtar dhe mos ta shqyrtoj [...] kurrë”*. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjyqtari A.G. në seancën e 9 shkurtit 2018, e ka shtyrë seancën për këtë rast pa ndonjë bazë ligjore.
 - c) Se Gjykata Themelore e ka *“stopuar lëndën që 12 vite”* dhe nuk po e bënë rigjykimin dhe as nuk po na mundëson që kjo lëndë të bartet në ndonjë gjykatë tjetër.
26. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon sërish që t'i mundësohet që rasti i tij të vendoset dhe ngastrat e kontestuarat t'i *“kthehen në posedim”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parapara më tej në Ligi dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

29. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e parashtruara në nenin 113.7 të Kushtetutës.
30. Megjithatë, Gjykata i referohet rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, ... nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata ...”.

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, në këtë kërkesë (KI110/18) kërkon nga Gjykata që t'i merr parasysht përsëri pretendimet e tij të ngritura në kërkesën e mëparshme KI18/18.
32. Gjykata rikujton se në kërkesën e mëparshme të parashtruesit (KI18/18) i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e ngritura nga ai, duke iu përgjigjur veç e veç secilit prej tyre, duke marrë parasysht praktikën relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 7 shkurtit 2002, *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, paragrafi 38), si dhe praktikën e saj të deritanishme lidhur me kohëzgjatjen e procedurës (shih, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI23/16, parashtrues i kërkesës: *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, të 5 majit 2017, paragrafi 58).
33. Sa i përket kësaj kërkesë (KI110/18), parashtruesi, përveç kërkesës së parashtruar më 3 gusht 2018, i dorëzoi Gjykatës edhe dokumentet shtesë më 28 gusht 2018 dhe 7 shtator 2018.
34. Megjithatë, Gjykata duke analizuar përmbajtjen e tyre dhe pretendimet konkludoi se ato, në fakt, sipas përmbajtjes së tyre janë të njëjtat parashtresa të cilat ai tashmë i kishte parashtruar në Gjykatë në rastin KI18/18.
35. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kjo kërkesë nuk paraqet ndonjë rrethanë të re për tu konsideruar përsëri nga Gjykata. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë kërkesë (KI110/18), Gjykata tashmë ka vendosur në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI18/18.
36. Prandaj, Gjykata konsideron se në këtë kërkesë parashtruesi nuk ka dorëzuar ose paraqitur asnjë provë ose ndonjë rrethanë të re, e cila do të ndikonte dhe kontribuonte që Gjykata t'i rishikojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura nga ai në kërkesën e mëparshme KI18/18, për të cilat Gjykata vendosi me Aktvendimin për papranueshmëri të 30 majit 2018 (shih, ngjashëm me këtë situatë, Vendimin për refuzimin e kërkesës së Gjykatës Kushtetuese në rastin KI26/14, me parashtruesin e kërkesës: *Bajrush Gashi*, të 26 marsit 2015, paragrafi 24).

37. Gjkata rikujton se ankesa individuale sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtruesi i kërkesës si mundësi për të kërkuar prapë nga Gjkata rishikimin e pretendimeve apo rihapjen e vendimeve për çështjet për të cilat Gjkata ka vendosur njëherë.
38. Përveç kësaj, Gjkata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (shih, ndër të tjera, vendimin e Gjkatës Kushtetuese në rastin KI26/14, parashtruesi i kërkesës: *Bajrush Gashi*, të 26 marsit 2015, paragrafët 26 dhe 27).
39. Si përfundim, Gjkata konsideron se kërkesa e parashtruesit, në fakt, është përsëritje e një kërkesë të mëparshme për çështjen e cila tashmë është vendosur nga Gjkata. Prandaj, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kjo kërkesë duhet të refuzohet si e palejueshme me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjkatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

